

RREGULLORE E BRENDSHME E VEPRIMTARIVE TE ATLETIKES

NENI 1

QELLIMI

Veprimtaritë lokale kombëtare dhe ndërkombëtare kanë për qëllim zhvillimin psikologjik, fizik të Rinisë në përgjithësi e të ndikojnë në gjallërimin e jetës së njerëzve si dhe të ngrejnë në shkallë sa më të lartë rezultatet sportive si një nga qëllimet kryesore të kësaj veprimtarie.

NENI 2

DREJTIMI DHE ORGANIZIMI

1. Gjithë veprimtaritë lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare, drejtohen nga FShA me anë të Sektorit të Sportit pranë Bashkive dhe Klubeve Sportive në rrethe.

Në këto veprimtari, FShA dërgon përfaqësues të cilët së bashku me drejtuesit e rrethit mbajnë përgjegjësi për mbarëvajtjen e aktivitetit të caktuar në bazë të Kalendarit Kombëtar të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

FShA, në bazë të buxhetit të miratuar nga Ministria, u kërkon Bashkive dhe Shoqatave Sportive (Klubeve Sportive) që të zbatojnë Kalendarin Sportiv Vjetor, e të marrin masat e nevojshme për organizimin e aktiviteteve po sipas Kalendarit kur zhvillohet në rrethin apo qytetin e tyre.

Nëpërmjet Kryesisë, FShA harton e zbaton një plan kualifikimi trajnerësh e gjyqtarësh si brenda e jashtë vendit.

10 ditë para fillimit të veprimtarisë, Klubi Sportiv në bashkëpunim me Sektorin e Sporteve pranë Bashkisë, i dërgon FShA-së informacion të plotë për gjendjen e stadiumit, bazën materiale si dhe planin për masat teknike e organizative për mbarëvajtjen e aktivitetit.

2. Sektori i Sportit pranë Bashkisë dhe Klubi Sportiv përgjigjen:

- a) Për organizimin e veprimtarive lokale, kombëtare e ndërkombëtare që zhvillohen në rrethin e qytetin e tyre.
- b) Merr masa për sistemimin e ekipeve sportive në hotele të tjera.
- c) Për progandimin e aktivitetit dhe të Atletikës në përgjithësi.
- d) Për caktimin e gjyqtarëve sipas kategorisë që i korrespondon aktiviteti duke bashkëpunuar me FShA dhe me Kolegiumn e Gjyqtarëve.

NENI 3

VENDI, DATA DHE MENYRA E ZHVILLIMIT TE AKTIVITETIT

1. Vendi dhe datat e aktivitetit caktohen në Kalendarin Sportiv Kombëtar në Sektorin e Federatës. Ndryshimet e datave të aktiviteteve kombëtare bëhen vetëm me miratimin e Komitetit Drejtues, mbështetur në statutin e FShA neni 27 pika j, ku FShA lajmërohet 15 ditë përpara aktivitetit.

2. Kur kushtet atmosferike nuk janë të përshtatshme, Kryegjyqtari, duke marrë mendimin e përfaqësuesve të Federatës, ka të drejtë të ndryshojë orarin e garave brenda një ditë ose t'i zhvendosi ato në ditën pasardhëse, e në pamundësi tjetër, mund të akordojë një ditë shtesë. Kjo bëhet me miratimin e Sektorit të FShA.

NENI 4

PJESEMARRJA

1. Në të gjitha aktivitetet kombëtare të atletikës marrin pjesë të gjithë atletët nga të gjitha rrethet e klubet e vendit të cilët kanë arritur më parë në kategorinë përkatëse sportive për çdo moshë e caktuar kjo në Klasifikimin Unik Sportiv të Federatës.

2. Atletët marrin pjesë mbi bazën e grupmoshave, Atletët e përparuar në rezultate marrin pjesë sipas kategorive përkatëse kur janë mbi 14 vjeç për vajza dhe mbi 15 vjeç për djem.

3. Në Kampionatin Kombëtar të të Rriturve marrin pjesë vetëm atletët që kanë arritur në kategorinë e I-rë dhe të II-të sportive gjatë vitit kalendarik në vazhdim. FShA ruan të drejtën të ftojë atletë në gara të veçanta.

4. Atletët me trajtim nga FShA apo nga KOKSH, apo me trajtim të veçantë, justifikojnë mos-pjesëmarrjen e tyre në gara vetëm me raport mjekësor të konfirmuar dhe nga mjeku i garës; në rast të kundërt do të ketë sanksione.

5. Në veprimtaritë Kombëtare nuk lejohet të marrin pjesë atletë jashtë gare. Atletët e cilësisë së lartë përveç dy garave të lejuara me rregullore lejohen të marrin pjesë edhe në një garë të tretë për efekte rezultati të lartë, por pa të drejtë pikësh. Kjo bëhet me miratimin e përfaqësuesit të Federatës.

6. Në stafetë, mund të regjistrohen 4 pjesëmarrës dhe dy rezervë. Në mbledhjen e përgjegjësve të ekipit mund të bëhen ndryshimet e fundit në federimet (gjithmonë me argumenta). Vetëm me stafetat në raste të veçanta munden ndryshimet e fundit të bëhen brenda 6-shes deri në 5 minuta para gare.

NENI 5

DOKUMENTACIONI

1. Për të gjitha aktivitetet Shoqatat Sportive (Klubet Sportive) duhet të regjistrojnë në Federatë listat e federimit me të gjitha kërkesat e tyre.

Këto duhet të jenë në zyrat e Federatës 5 ditë përpara fillimit të aktivitetit; në rast të kundërt Shoqata (Klubi Sportiv) nuk lejohet të marrë pjesë në aktivitet.

2. Për të gjitha moshat, Përgjegjësi i ekipit duhet të ketë me vete certifikatat e atletëve me fotografi të vulosura nga gjendja civile ose paraporta nëse i kanë.

3. Listat e federimeve detyrimisht duhet të kenë firmat e Drejtuesit të Shoqatës (Klubit Sportiv), përgjegjësit të ekipit si dhe të mjekut. Gjithashtu duhet të jenë të vulosura me vulën e Shoqatës (Klubit) ku bën pjesë.

4. Brenda datës 25 dhjetor të çdo viti, Klubet ose Shoqatat Sportive duhet të dërgojnë në FShA listat emërore të të gjitha moshave që do të aktivizohen në vitin pasardhës duke u bërë më parë anëtarë të FShA, pra duke u licensuar.

5. Çdo atlet, trajner, përgjegjës ekipi, mjek apo gjyqtar do të marrë pjesë në aktivitetin Kombëtar vetëm atëherë kur është bërë anëtar i FShA dhe të jetë i pajisur me librezë anëtarësie. Në të kundërt, nuk do të lejohet pjesëmarrja.

NENI 6

KLASIFIKIMI

1. Për aktivitetet kombëtare do të ketë klasifikim individual dhe ekipor për M+F.
2. Klasifikimi individual do të jetë deri në vendin e 8-të me pikëzim: 8 pikë, 7, 6, 5, 4, 3, 2, 1 pikë. Stafetat do të vlerësohen njësoj si garat individuale, pra me 8 pikë vendi i I-rë e me rradhë. Kur finalja zhvillohet me 6 finalistë, i 7-ti dhe i 8-ti marrin pikë sipas kohës që kanë arritur në eliminatorë. Në rast kohe të barabarta, pikët mblidhen dhe pjesëtohen për dy.
3. Kur garat zhvillohen me dy bateri, në finale hyjnë 2 të parët e çdo baterie dhe të tjerët janë me kohë. Kur janë më shumë se dy bateri në finale, hyn i pari i çdo baterie dhe të tjerët me kohë. Kur janë mbi 5 bateri, garat zhvillohen me çerek finale, gjysëm finale dhe finale.
4. Garat e stafetave zhvillohen me kohë direkt me finale. Në garat e 800m e lart, atletët më të mirë grupohen në një bateri sipas kohëve të realizuara më parë, por me kusht që numri i tyre të mos kalojë 12 vetë. Në çdo rast, atleti më i mirë, rekordmeni apo kampioni, zgjedh korsinë, rradhën e hedhjeve apo rradhën e kërcimeve. Atletët e tjerë hedhin shorte.
5. Atletët që thyjnë Rekordin Kombëtar vlerësohen në klasifikim me +5 pikë. Në rast barazimi rekordi vlerësohen me +3 pikë.
6. Normat për rekorde të nivelit cilësor si dhe thyerjet apo barazimet e rekordeve kombëtare, që të quhen të vlefshme duhet të homologohen nga kryegjyqtari i garave dhe nga përfaqësuesi i FShA.
7. Klasifikimi ekipor del mbi bazën e pikëve të grumbulluara. Në rast barazimi pikësh vlerësohet ekipi që ka realizuar: a) Rekord Kombëtar; b) Barazim Rekord; c) Vende të para; d) Kategori të Para; e) Vende të dyta; f) Kategori të dyta; g) Vende të treta; h) Kategori të treta.
8. Nga çdo aktivitet të dalë atleti dhe atletja më e mirë në bazë të rezultatit të arritur dhe Pikëve Olimpikë, të cilët nderohen me kupë.
9. Veç shpërblimit me pikë që shkojnë në favor të ekipit, atletët do të shpërblehen dhe me të holla komform ligjeve në fuqi V.K.M. shkresë 1720 dt. 29.10.2008.

Shënim: Programet e garave një dhe dy ditore janë të treguara në buletin vjetor që boton Federata e Atletikës. Në rast ndryshimi të programit, Federata do të njoftojë 15 ditë para aktivitetit. Kur aktivitetet zhvillohen 1 ditore, organizimi do të jetë si ai i mitingjeve, pra, direkt në finale.

NENI 5

GJYQTARIA

1. Në veprimtaritë Kombëtare të Atletikës, gjyqtari dërgohet nga rrethi si dhe nga vendi organizator sipas listave të Kolegiumit Qendror në bashkëpunim me FShA dhe me Kolegjuemet e rretheve. Gjyqtarët duhet të jenë më kategorinë përkatëse të aktivitetit të pajisur me uniformë (pantallona të zeza dhe xhaketë blu dhe me bexhe ku të jete vendosur emri dhe fotoja).
2. Gjyqtari duhet të jetë i pajisur me librezën e anëtarësimit nga FShA. Të jetë i përgatitur të zbatojë me rreptësi rregulloren teknike e të jetë kërkues dhe korrekt.

3. Detyrimisht duhet të marrë pjesë në seminaret teknike që zhvillohen gjatë aktivitetit ose në një kohë tjetër nga Federata.
4. Gjyqtari në sektorin ku gjykon duhet të mbajë rregull, të mos pranojë atletë me uniforma të papërshtatshme, pa numër, si dhe të gjykojë e të veprojë me kompetencë sipas rregullores teknike dhe rregullores së brendshme.
5. Rreth 30 minuta para fillimit të garës, t'i raportojë përgjegjësit të sektorit e kryegjyqtarit të garave për gjendjen e kushteve teknike dhe te bazës materiale që disponon. Të fillojë garën vetëm atëherë kur këto të jenë sipas rregullores në kushte normale.
6. Gjyqtari në asnjë rast nuk duhet të hyjë në debat me atletin, trajnerin, publikun dhe përgjegjës të tjerë. Atij i ndalohej të vijë i pirë dhe të pijë duhan në ambjentet sportive.
7. Në rastet kur nuk zbatohen kërkesat e mësipërme, Kryegjyqtar së bashku me përfaqësuesin e Federatës marrin masa për pezullimin dhe zëvendësimin e tij. I takon Kolegiumit Qendror të gjykojë për dënimin e tij dhe kohëzgjatjen e masës.

KRYEGJYQTARI

Kryegjyqtari ka këto detyra:

1. Të marrë në dorëzim me proces verbal gjendjen e bazës materiale të sektorëve të pistës, të gropave e pedanës dhe të gjykojë mbi gjendjen e tyre.
2. Një ditë para aktivitetit në ora 19:00 bën mbledhjen me gjyqtarinë si dhe merr pjesë në mbledhjen me përgjegjës të ekipeve.
3. T'u caktojë detyrat gjyqtarëve dhe të bëjë shpërndarjen e tyre.
4. Për çdo problem që del gjatë garave mban lidhje me përgjegjës të ekipeve apo trajnerët përgjegjës.
5. Bën konkluzionet e aktivitetit së bashku me përfaqësuesit e FShA.
6. Pas mbarimit të veprimtarisë shpall rezultatet përfundimtare dhe harton relacionin përkatës.
7. Ka të drejtë të pezullojë e të përjashtojë nga aktiviteti çdo gjyqtar, përgjegjës ekipi, trajner apo atlet që shkel rregulloren e pengon aktivitetin e mbarëvajtjen e garave. Këto i shënon me relacionin përfundimtar e gjithashtu këto të drejta i ka edhe përfaqësuesi i Federatës.
8. Anulon në bashkëpunim me përfaqësuesit e FShA garën nëse nuk plotëson të gjitha kushtet e nevojshme që ka gabime teknike dhe parregullsi në gjykim, etj.
9. Firmos të gjitha protokollet, homologon rekordet, sposton (për arsye objektive) oraret si dhe përgjigjet për të gjithë rregullin e brendshëm të aktivitetit.

SEKRETARI I PERGJITHSHEM I GJYQTARISE

Ka këto detyra:

1. Ben verifikimin, evidentimin e çdo ekipi pjesëmarrës M+F, trajnerëve, gjyqtarëve të çdo rrethi e klubi e nxjerr shumën e përgjithshme të tyre.
2. Plotëson protokollet me pjesëmarrësit për secilën garë.
3. Verifikon me Gjyqtarinë Qendrore dokumentet e pjesëmarrësve një ditë para veprimtarisë në mbledhjen me përgjegjës të ekipeve.
4. Bën proces-verbalin e verifikimit të moshave mbi bazën e certifikatave të ardhura.

5. Ndan bateritë sipas llojit të aktivitetit mbi bazën e rregullores së brendshme.
6. Evidenton kategoritë, rekordet, pikët, klasifikimin përfundimtar si dhe përcakton atletët më të mirë të aktivitetit.
7. Pranon vetëm protokollet me shkrim të qartë, me emër mbiemër të plotë dhe të plotësuar në bazë të kërkesave që përmban protokollin.
8. Mbledh dhe ruan proces-verbalet e thyerjeve apo barazim rekordesh kombëtare të çdo grup moshe.
9. Për çdo shkelje, njofton menjëherë përfaqësuesit e FShA si dhe Kryegjyqtarin e garës.

SEKRETARI I PERGJITHSHEM I GJYQTARISE

Kanë këto detyra:

1. Në bashkëpunim me sekretarin e përgjithshëm plotësojnë protokollet për secilën garë në mënyrë të pastër dhe pa gabime në dy kopje. Në rast se protokollin korrigjohet i bashkangjitet protokollit të ri duke e nënshkruar korrigjimin dhe nga përgjegjësi i sektorit.
2. Nxjerr rezultatet përfundimtare dhe nënshkruan protokollin së bashku me gjyqtarët përkatës.
3. Përpilojnë proces verbalet për rekordet si dhe barazim rekordesh të cialt pasi i nënshkruan ua jep për firmë gjyqtarëve, kryegjyqtarit, përfaqësuesit të Federatës dhe i bashkangjit protokollit.

PERGJEGJESIT E SEKTOREVE

Kanë këto detyra:

1. Verifikojnë 1 orë përpara fillimit të garave sektorët e tyre dhe për çdo mungesë apo nevojë njoftojnë Kryegjyqtarin e garës dhe marrin masa për rregullimin e tyre.
2. Bëjnë shpërndarjen e gjyqtarëve sipas detyrave që do të kryejnë si dhe kontrollojnë vendosjen e tyre.
3. Marrin në ngarkim dhe dorëzojnë në fund bazën materiale të nevojshme duke i kontrolluar e peshuar sipas rregullores përkatëse dhe pastaj e fusin në garë.
4. Shikojnë nëse janë plotësuar kërkesat e sigurimit teknik dhe për çdo mangësi njoftojnë Kryegjyqtarin dhe përfaqësuesin e FshA.
5. Pezullojnë garat kur mungojnë e prishen kushtet normale për zhvillimin e tyre duke njoftuar më parë përfaqësuesin e FshA dhe Kryegjyqtarin.

NENI 8

RREGULLORE E VEPRIMTARISË NË NATYRË

1. Vrapimet në natyrë (krosët), vrapimi në mal dhe maratonat zhvillohen sipas Kalendarit Kombëtar. Në këto marrin pjesë të gjitha Shoqatat e vendit (Klubet sportive) si dhe individë që janë anëtarë të FshA të pajisur me librezë anëtarësie.
2. Distancat janë 4000 metra dhe 6000 metra për femra si dhe 6000 metra, 8000 metra dhe 12000 metra për meshkujt të ndarë sipas moshave të përcaktuara në rregulloren e FshA.

3. Pjesëmarrja për çdo ekip lejohet 4 femra ku klasifikohen 3 atlete dhe 4 meshkuj ku klasifikohen 3 atletë.
4. Klasifikimi është individual dhe ekipor kur përmbushen kushtet e klasifikimit, pra 3 atlete femra dhe 3 atletë meshkuj.
5. Klasifikimi do të jetë me pikë të vogla, dmth, vendi i I-rë me 1 pikë, II-ti me 2 pikë, i III-ti me 3 pikë e kështu me rradhë.

VLERESIMET

1. Në të gjitha aktivitetet, vendet e I-ra, II-ta dhe III-ta nderohen me diploma duke përfshirë këtu dhe stafetat. Po kështu, nderohen edhe të tre ekipet fituese.
2. Në Kampionatin Kombëtar të Rriturve të gjithë kampionët nderohen me medalje.
3. Në të gjitha aktivitetet për të gjitha moshat, ekipet që klasifikohen të parët nderohen me Kupa si për femra ashtu dhe për meshkuj.

NENI 9

UDHEZIME KRYESORE PER ZHVILLIMIN NORMAL TE AKTIVITETEVE

1. Një ditë para fillimit të aktivitetit, përfaqësuesi i FShA, Kryegjyqtari, Sekretari i aktivitetit të ndodhen në vendin organizator për të kontrolluar dhe marrë masat për zhvillimin sa më normal të aktivitetit.
2. Po atë ditë në orën 18:00 bëhet mbledhja me të gjithë përgjegjësit e ekipeve për të verifikuar apo ndryshuar formacionin si dhe ndryshime oraresh nëse do të jetë e kushtëzuar nga moti, stadiumi apo ndonjë shkak tjetër objektiv.
3. Po atë ditë, në orën 19:00 bëhet mbledhja e gjyqtarisë në prezencë të përfaqësuesit të FShA për përcaktimin dhe kompletimin e të gjithë gjyqtarive me gjyqtarë specialistë e të kualifikuar nga i gjithë kontigjenti i gjyqtarëve që disponohen.
4. Shoqatat Sportive (Klubet Sportive) apo individë të ekipeve private që nuk kanë dërguar listat e federimeve 5 ditë përpara në zyrat e FshA në mënyrë kategorike nuk do të pranohen në aktivitet, qoftë edhe jashtë gare.
6. Listat e federimit detyrimisht duhet të jenë të firmosura dhe të vulosura nga drejtuesi i Klubit Sportiv. Gjithashtu, detyrimisht duhet të kenë ciklin e mjekut si dhe firmën e përgjegjësit të ekipit.
6. Për çdo problem që do të dalë gjatë zhvillimit të aktivitetit, Kryegjyqtari do të komunikojë vetëm me përgjegjësin e ekipit përkatës.
7. Vetëm përgjegjësi i ekipit ka të drejtë të bëjë reklamime teknike për gabimet apo padrejtësitë e vërejtura deri në 30 minuta pas përfundimit të garës pasi të ketë depozituar në sekretari 500 lekë të cilat i kthehen në rast se Komisioni Juridik i ngritur për shqyrtimin e ankesave konstanton apo gjykon se reklamuesi ka të drejtë, e në këtë rast i mbahen lekët shkaktarit të gabimit dhe për zgjidhjen e mëtejshme ata i drejtohen KAS sipas nenit 33.
8. Përgjegjësi i ekipit mban përgjegjësi për çdo ndodhi apo shkelje rregulloreje që ndodh nga pjesëtarët e ekipit të cilit ai përfaqëson. Ai përgjigjet për rregullat që duhen zbatuar nga pjesëtarët e ekipit të tij si në ambjentet ku zhvillohen garat ashtu dhe në hotel, restorant, etj.

9. Secili ekip detyrimisht duhet të konkurojë me uniformën e Klubit Sportiv që ai përfaqëson. Në asnjë rast nuk do të lejohet të marrin pjesë në garat e atletikës atletët që nuk plotësojnë këto kërkesa të domosdoshme dhe për këtë mban përgjegjësi Përgjegjësi i Ekipit dhe Përgjegjësi i Shoqatës.

NENI 10

RREGULLA TE SIGURIMIT TEKNIK

Për zhvillimin sa më normal të aktiviteteve kombëtare apo qoftë edhe të stërvitjeve, për disiplinat e hedhjeve duhen patur parasysh rregullat e mëposhtme të sigurimit teknik si dhe duhen zbatuar në çdo rast.

1. Të gjitha garat e hedhjeve mund të zhvillohen në stadium apo qendra stërvitore hedhjesh si në anekse stadiumesh.
2. Kur garat e çekiçit dhe të diskut do të zhvillohen në stadium, detyrimisht duhet të disponohen “Kafazet Mbrojtëse”. Në rast të kundërt, kur kafazet nuk disponohen, ato nuk do të zhvillohen apo do të zhvillohen në qendra ku ato disponohen.
3. Në ambientet ku do të zhvillohen këto gara, përveç gjyqtarisë e cila duhet të jetë shumë e vëmendshme dhe të zbatojë rregullat, nuk do të lejohet asnjë person tjetër.
4. Atletët që kanë rradhën e hedhjes nuk do të lejohen të futen në fushë për të marrë veglat. Ato kthehen nga gjyqtarët e garës.
5. Kur një atlet është duke kryer hedhjen apo flakjen, të tjerët qëndrojnë në një largësi optimale prapa kafazit e gjithashtu gjyqtaria dhe sekretarët. Pranë atletit qëndron vetëm gjyqtari i faulleve.
6. Veglat e garave duhet të depozitohen në gjyqtari një ditë para aktivitetit për t’u peshuar, matur e kontrolluar sipas standardeve.
7. Pedanat e hedhjeve duhet të plotësojnë standardet, të jenë të pastra e të vizuara dhe të tilla të mbahen gjatë zhvillimit të garës.

NENI 11

HOMOLOGIMI I REKORDEVE PER TE GJITHA MOSHAT

Homologimi i një rekordi bëhet nga Kryegjyqtari, Përfaqësuesi i Federatës e Gjyqtaria në këto raste:

- a) Në rastin e vrapimeve, kronometrat duhet të jenë 3 e të mos startohen pa u lajmëruar nga Kryegjyqtari si përfaqësues i Federatës.
- b) Në rastin kur ka matës ere, shpejtësia e saj shënohet në protokoll me + apo – qoftë. Nëse është + ajo nuk duhet të kalojë +2m/s e në të kundërt, rezultati njihet por nuk është homolog si rekord.
- c) Që në atë moment, duhet bërë procesverbali i rekordit që duhet të plotësohet nga përgjegjësi i gjyqtarisë përkatëse duke shënuar në të të gjitha hollësitë e rrethanat e vendosjes apo thyerjes së rekordit. Gjithashtu procesverbali duhet të firmoset nga Kryegjyqtari i garës si dhe nga përfaqësuesi i Federatës.
- d) Në rastin e kërcimeve, nuk duhet të lëvizet piketa e kërcimit rekord pa ardhur më parë Kryegjyqtari i garës dhe përfaqësuesi i Federatës.

e) Rekordi homologohet dhe bëhet procesverbali pasi të jetë bërë më parë kontrolli i metrit matës si dhe niveli i pedanës me gropën dhe sipërfaqen e rërës.

f) Në rastin e hedhjeve veprohet po kështu, nuk lëviz piketa, kontrollohet metri, pedana, niveli i saj si dhe hartohet procesverbali me të gjitha të dhënat duke bërë dhe rezultatin numër “çift” psh nga 59.47m në 59.48m. Në procesverbal shënohet dhe pesha e veglës e kontrolluar nga gjyqtaria brenda tolerancave të lejuara.

Shtizës i matet dhe gjatësia, vendosja e litarit dhe pesha.

Cekiçit i matet pesha, gjatësia e telit dhe doreza.

Diskut i matet pesha, sipërfaqja e lëmuar që të mos jetë me dhëmbëza e gërvishtje, etj.

Gjyles pesha dhe diametri.

g) Homologimin përfundimtar e jep Sekretari i Federatës me Drejtorin e saj Teknik pasi shqyrtojnë me parë dokumentacionin përkatës.

Nga Federata Shqiptare e Atletikës

14 prill 2015